




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 83/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina – Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas nenit 24 të Rregullores së punës së OSHP-së, përkitazi me ankesën e parashtruar nga operatori ekonomik: “NNT Eing Com” Podujevë kundër njoftimit për anulim e aktivitetin të prokurimit me titull “Furnizim i shportave të Xhepit dhe ulëseve” me nr prok:616-18-5173-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Prishtinës më datën 02.04.2019 mori këtë:

U R D H Ë R E S Ë

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik : “NNT Eing Com” Podujevë kundër njoftimit për anulim e aktivitetin të prokurimit me titull “Furnizim i shportave të Xhepit dhe ulëseve” me nr prok:616-18-5173-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Prishtinës.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës që të zbatojë vendimin e OSHP-së me numër: PSH nr.488/18, të datës: 24.10.2018,dhe vendimi PSH nr.694/19,i datës:08.01.2019, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim i shportave të Xhepit dhe ulëseve” me nr prok:616-18-5173-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Prishtinës.

III. URDHËROHET, autoriteti kontraktues / Komuna e Prishtinës , që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në, dhe operatorin ekonomik OE “NNT Eing Com” Podujevë lidhur me zbatimin, e vendimit të OSHP-së, PSH nr.488/18, të datës: 24.10.2018,dhe vendimi PSH nr.694/19,i datës:08.01.2019, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim i shportave të Xhepit dhe ulëseve” me nr prok:616-18-5173-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Prishtinës.

IV. Mos respektimi i kësaj urdhërese, brenda periudhës prej pesë ditë kalendarike, do ta detyroj panelin shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe njëkohësisht të kërkoj nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK Komuna e Prishtinës /sipas nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “NNT Eing Com” Podujevë , aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 13.07.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 09.08.2018

Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit e eliminuar: 14.11.2018

Data e njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit: 06.02.2019

Kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik: “NNT Eing Com” Podujevë me dt: 11.02.2019, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues

Autoriteti Kontraktues me datën 13.02.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: “NNT Eing Com” Podujevë si të pa bazuar dhe njëkohësisht ka marrë vendim që ta anuloj këtë aktivitet të prokurimit.

Operatori ekonomik ankues “NNT Eing Com” Podujevë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 22.02.2019 me nr. 83 / 19, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizim i shportave të Xhepit dhe ulëseve” me nr prok:616-18-5173-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “Komuna e Prishtinës” duke pretenduar se:

Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,59,69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 41,28 të RrUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.02.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 07.03.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues "NNT Eing Com" Podujevë pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

OE ankuese "N.N."EING COM"-Podujevë , pretendon se AK-Komuna e Prishtinës nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, Ky nen është shkelur pasi që AK-ja nuk i ka vlerësuar të gjithë OE njësoj sipas OE ankues.

Ekspertja shqyrtues konstaton se neni 7 i LPP-së është shkelur nga AK, pasi që AK ka vlerësuar në mënyrë jo të drejtë ofertën e OE Ankues sepse i njëjti i ka plotësuar të gjitha kriteret e te parapara në njoftimin për kontratë dhe me dosjen e tenderit dhe është OE. me çmim më të lirë, është shpallur OE i eliminuar,duke u vlerësuar jo plotësisht siç parashihet me nenin 59 të LPP-së

Gjatë rivlerësimit ka filluar ta bëjë hulumtimin e tregut ku me datë 23.01.2019 përmes emailit ua ka dërguar disa Operatoreve Ekonomik paramasën dhe ka kërkuar ti dërgon çmimet për artikullin ose njërin nga artikujt të ndara në pjesët e artikullit të përshkrimi i çmimit dhe ka pranuar 5 oferta për hulumtim tregut ,pastaj ka nxjerrë mesataren e çmimeve për njësi dhe vetëm këtë krahasim e ka bërë pa i kalkuluar siç ishte e paraparë me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë në bazë të poentimit andaj AK. ka pasur obligim ta nxjerr përqindjen sipas poentimit pastaj ta përfundojë vlerësimin dhe ta konstatojë se OE Ankues ka ofertuar ose jo me çmim më të lart sesa çmimet e tregut, nuk është e mjaftueshme dhe bindes për të ia falur besimin dhe mohuar pretendimin e OE. ankues i cili pretendon se gjatë vlerësimit ka pasur tendencë të mos i jepet kontrata duke mos e trajtuar në mënyrë të barabartë konform nenit 7 të LPP Barazia në trajtim jo diskriminim

OE ankues pretendon se është shkelur neni 59 i LPP-së Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe neni 41 i Rregullave dhe UOPP-së Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Ekspertja shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar, Sepse nuk i është ofruar qasja në dokumente zyrtare plotësisht dhe nuk është bërë vlerësimi sipas LPP-së .

OE. ankues pretendon se në mënyrë kundërligjshme janë pranuar ofertat për hulumtimin e tregut dhe me datë 06.02.2019 ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare, AK të njëjtën ditë i ka ofruar qasje në dokumente . OE ka kërkuar edhe dëshmitë ofertat në bazë të cilave është bërë hulumtimi i tregut ,AK. nuk ia ka ofruar këto dokumente me arsyetimin se janë dokument konfidenciale

AK gjatë rivlerësimit ka filluar ta bëjë hulumtimin e tregut ku me datë 23.01.2019 përmes emailit ua ka dërguar disa Operatoreve Ekonomik paramasën dhe ka kërkuar ti dërgojnë çmimet për artikullin ose njërin nga artikujt të ndara në pjesët e artikullit të përshkrimi i çmimit . AK ka pranuar 5 oferta për hulumtim e tregut ,pastaj në bazë të këtyre ofertave ka nxjerrë mesataren e çmimeve për njësi ku për pozicionin 1. mesatarja sipas AK së ju del 252.9 € dhe për pozicionin 2 është çmimi mesatar 24.4 € dhe vetëm këtë krahasim e ka bërë pa i kalkuluar siç ishte e paraparë me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë pikët në bazë të poentimit andaj AK. ka pasur obligim ta nxjerr përqindjen sipas poentimit pastaj ta përfundojë vlerësimin dhe ta konstatojë se OE Ankues ka ofertuar ose jo me çmim më të lart sesa çmimet e tregut,

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se janë pranuar ofertat në mënyrë të kundersligjshme gjatë rivlerësimit

Ekspertja konstaton se ky pretendim nuk qëndron sepse AK-së ka jo vetëm të drejtë por edhe është i obliguar të bëjë hulumtimin e tregut sa i përket çmimeve prandaj pretendimi i OE së ankues është i pa bazuar .

Sa i përket pretendimit të OE ankues se ju ka mohuar e drejta në qasje në dëshmi -ofertat e ofruara për hulumtim tregu me arsyetim se janë dokumente konfidenciale .

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuar sepse në mënyrë të padrejtë i është mohuar e drejta për qasje në dokumente sepse oferta financiare nuk është dokument konfidencial dhe në ato dokumente nuk është kërkuar nga ofertuesit të trajtohen si konfidenciale .

AK. me rastin e përpilimit të dosjes së tenderit i ka peshuar rëndësinë poentimit në dy pozicione ku njërit pozicioni i ka jep rëndësi poentomi 93 % kurse pozicionit tjetër 7% . AK duhet ti përmbahet kritereve të parapara me dosjen e tenderit, prandaj do duhej të bënte kalkulimin e ofertave në bazë të poentimit këtë po e demonstroj për shkak të korrektësisë në mënyrë tabelore

Kalkulimi me përqindje-Poentimi

N.T.P. „DAQA’’ N.N. „Eing com’’

$c = CU/CT \times 100 \times 93\%$

$$C = 220/204.6 \times 100 \times 93\%$$

Poz . 1	220	220
	350	220
	100	100
	93%	93%

Poentim	58	93
Poz. 2.	45	
	45	445
	100	100
	7%	7%

Poentimi	7	1
Totali i poentimit	65	94

Kjo formë e kalkulimit është bërë bazuar në kriteret e parapara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, përveç këtyre dy Operatorëve që kanë aplikuar kalkulimi, krahasimi dhe nxjerrja e mesatares edhe nga ofertat e pranura për hulumtim të tregut Autoriteti Kontraktues në këtë formë do duhej ti kalkulonte dhe krahasonte çmimet e tregut , e jo siç i ka krahasuar çmimet për njësi duke e nxjerrë mesataren e çmimeve për njësi.’

Ekspertja konstaton se ky pretendim qëndron sepse ekzaminimi ,vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe nenit 41 i Rregullave dhe UOPP-së
OE pretendon se është shkelur neni 62 i LPP Përfundimi i Aktivitetit të prokurimit

Ekspertja shqyrtuese konstaton se ky pretendim ankimor është i bazuar sepse AK me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit nuk ka dhënë asnjërin nga arsyet e parapara në nenin 62 të LPP. së siç janë:

Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet se një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo Anulimi i aktivitetit të prokurimit pa u ndërlidh me njërin nga këto arsye është i pa bazuar. OE pretendon se është shkelur neni 69 Lidhur me aftësinë teknike dhe Profesionale ,

Ekspertja e prokurimit konstaton se ky pretendim është i pa bazuar sepse AK nuk e ka eliminuar nga gara dhe nuk e ka anuluar aktivitetin e prokurimit lidhur me aftësinë teknike ose Profesionale siç parashihen në nenin 69 të LPP-së OE pretendon se është shkelur nen 28 Rregullave dhe UOPP-së -Kriteret e dhënies së kontratës.

Ekspertja shqyrtuese konstaton se ky pretendim ankimor është i bazuar sepse AK me të drejtë e ka vlerësuar ofertën e OE. ankues dhe nuk e ka mohuar faktin se operatori ekonomik ankues do dilte fitues sikur mos të anulohet aktiviteti i prokurimit

OSHP-ja me vendimin 488/18 paneli shqyrtues ka rekomanduar autoritetit kontraktues të ketë parasysh nenin 6 dhe 1 të LPP. së duke theksuar se AK është i obliguar ta ketë në konsideratë nenin 6 dhe 1 të LPP.se të cilët për qellim kanë ruajtjen e buxhetit .

OSHP-ja me vendimin 694/18 paneli shqyrtues ka rekomanduar autoritetit kontraktues të ketë parasysh nenin 6 dhe 1 të LPP-së duke theksuar se AK është i obliguar ta ketë në konsideratë nenin 6 dhe 1 të LPP.se të cilët për qellim kanë ruajtjen e buxhetit.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 dhe 60 të LPP-së. Paneli shqyrtues i OSHP-së duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të

prokurimit obligon AK-së K.K. Prishtinë ,që gjatë rivlerësimit të ofertave të bënë vlerësimin real të ofertave sipas kërkesave të vendosura nga vet AK-së në Njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit .

Ekspertja shqyrtuese konstaton se ky rekomandim nuk është respektuar plotësisht nga AK-së me rastin e rivlerësimit sepse me rastin e rivlerësimit nuk është bërë kalkulimi dhe nuk janë nxjerr piket e poentimit siç ishte i obliguar me vendim të OSHP-së ,me njoftim për kontratë dhe me dosjen e tenderit . Nuk i kanë kalkuluar ofertuesit sipas kriterëve të vendosura në Njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit që vet e kanë poentuar me 93% dhe 7% . por vetëm e kanë nxjerr mesataren e çmimeve për njësi ,andaj mendoj se nuk është respektuar plotësisht vendimi i OSHP. së.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e Operatorit Ekonomik “NNT EingCom” ta aprovoj si pjesërisht të bazuar dhe të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.04.2019, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave dhe ri vlerësimit, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të OSHP-së, vendimet e OSHP-së, PSH nr.488/18, të datës: 24.10.2018, dhe vendimi PSH nr.694/19,i datës:08.01.2019, dhe parashtrësat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues sqaron se me vendimin PSH nr. 488/18 të datës 24.10.2018,dhe vendimin 694/19 te datës:08.01.2019 : OSHP- ja ka vendosur që të “aprovohet si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE: “NNT EingCom” Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim i shportave të Xhepit dhe ulëseve” me nr. prok:616-18-5173-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Prishtinës dhe të anulohet njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit me titull “Furnizim i shportave të Xhepit dhe ulëseve” me nr. prok:616-18-5173-121 dhe lënda kthehet në rivlerësim.

Përves kësajë përmes arsyetimit të të njëjtëve vendime është sqaruar dhe konstatuar shumë qartë se neni 62 i LPP-së e as as neni 44 i RRUOPP nuk ka specifikuar arsyen e anulimit të aktivitetit të prokurimit ashtu siç AK –ja ka dhënë tek arsyetimi për anulim të aktivitetit të prokurimit në fjalë. Paneli shqyrtues sqaron se oferta e OE ankues është brenda planifikimit buxhetor te AK-së.

Paneli shqyrtues konstaton e autoriteti kontraktues nuk ka zbatuar vendimin e cekur si me lart PSH nr. 488/18 të datës: 24.10.2018, dhe vendimin 694/19 te datës:08.01.2019 , andaj ju bëjmë me dije se vendimet e OSHP-së, janë të obligueshme për tu zbatuar nga ana e autoriteteve kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët kanë të drejt ti drejtohen gjykatës kompetente brenda afatit ligjor me anë të mjeteve të rregullta juridike, konform këshillës juridike të dhënë në vendim.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 dhe 105 paragrafi 2.10 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të kësaj urdhërese

Urdhëresa t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Prishtines

1x1OE “NNT Eing Com” Podujevë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

